



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:084936

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05388584

C.nr.568/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses U.P nga Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.N.M nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 28.02.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses U.P nga Komuna e Vushtrrisë ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën nga data 03.12.2019 e deri me datë 21.11.2022 apo për 427 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj paditëses U.P, shumën prej 854.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 05.05.2021 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi të përgjithshme prej 124.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e nesërme e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja U.P nga, komuna e Vushtrrisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.N.M me seli në Vushtrri, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 05.05.2021, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që për periudhën kohore si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit dhe atë shumën prej 2 euro për çdo dite te pranisë ne pune apo shume e përgjithshme si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes se padisë e gjerë ne pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilim te padisë shumen pre 104 euro si dhe për takse gjyqësore 20 euro.

Gjykata me aktvendimin C.nr.568/21 të datës 17.10.2023, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 16.11.2023, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 30.11.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 05.05.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta hedhë poshtë si të palejuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të

palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritot.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe me kontrata e punës e datës 21.03.2017 kontestuese nuk ishte prania e paditëses në punë për 427 ditë, kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, si dhe vërtetimit të lëshuar me datë 19.12.2022, nga Drejtoria e Arsimit Shkolla e mesme e ulët “SH...”, në Vushtrri, për paditësen U.P për periudhën nga data 03.12.2019 e deri më 21.11.2022, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e bazuar, andaj edhe ia njohu shumën prej 854 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro (427 ditë të pranisë në punë x 2 euro = 854 euro).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar për periudhën nga data 03.12.2019 deri më 21.11.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e 2017 dhe pjesërisht edhe ajo e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 05.05.2021.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, duke llogaritur nga data 05.05.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke ia njohur paditëses shumën prej 124.00 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 20,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, ndërsa nuk ua njohu shpenzimet për precizim të kërkesëpadisë pasi që paditësja është dashur ta paraqesë kërkesën e kuart dhe të precizuar që në fillim të procesit gjyqësor.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:084936
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05388584

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.568/21/2021, datë: 28.02.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.